



## ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-6645

Me datë: 27.01.2023

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 nxjerrë këtë:

### V E N D I M

- I. **Remzi Bajselmani**, Drejtor në Drejtorinë për Arsim, caktohet zyrtar kompetent nga Komuna e Suharekës i cili do të shërbejë si person kontakti me Grupin Punues të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- II. Drejtoria për Arsim do të kujdeset për transportin dhe ushqimin e fëmijëve gjatë kësaj dite.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Në kuadër të aktiviteteve me rastin e shënimit të 15 - vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka për detyrë dhe përgjegjësi organizimin e ndezjes së 1133 qirinjëve nga 1133 fëmijë prej të gjitha Komunave të Republikës së Kosovës, në përkujtim dhe nderim të 1133 fëmijëve të vrarë nga forcat policore, ushtarake e paramilitare serbe gjatë luftës në Kosovë 1998/1999. Por për realizimin e këtij aktiviteti është i nevojshëm bashkëpunimi i Drejtorisë së Arsimit me shkollat në Komunën e Suharekës për përzgjedhjen e 35 fëmijëve të klasave 4 dhe 5 të ciklit të ulët për t'i dërguar me datë 17 shkurt 2023 në ora 16:00 në Prishtinë.

Kryetari i Komunës

**Bali MUHARREMAJ**

Kopje:  
Drejtorisë për Arsim;  
Palës;  
Arkivës.

